

Komunikatë për media

22 gusht 2007

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall rezultatet e valës 27 të privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të valës 27 të privatizimit, shpalli ofertuesit e përkohshëm fitues të Ndërmarrjeve të Reja.

Gjithsej 21 Ndërmarrje të Reja kanë qenë në dispozicion në këtë valë dhe të gjitha ishin në shitje përmes “Spin-ofit të rregullt”.

Ofertat u pranuan në zyrat qendrore të AKM-së në Prishtinë nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Ofertat janë hapur dhe rezultatet janë shpallur në selinë qendrore të UNMIK-ut, nga ora 13:00 deri në ora 15:00.

Gjithsej janë pranuar 94 oferta.

Vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte: €5,532,590

Rezultatet dhe fituesit e dhënë më poshtë janë të përkohshëm. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit tani është duke punuar që të përfundoj të gjitha shitjet, të cilat varen nga kontrollimi i historikut dhe përfundimi i pagesave nga ofertuesit e përkohshëm si dhe vendimi i Bordit të AKM-se.

Ndërmarrjet e Reja:	Ofertuesi	Çmimi
1. Bukosh	P88	7,500€
2. Nevolan	P92	10,800€
3. Vërnica	P90	10,800€
4. Dyqanet Stan Tërg Lux	P21	9,130€
5. IMB Restorani në Mitrovicë	P58	55,000€
6. KB Likovci tokë bujqësore	P23	20,972€
7. Dyqani Banana i Çyçavicës në Vushtrri	P69	17,750€
8. Ferma Kaçandoll – KB 23 Nëntori	P34	291,000€
9. Drelaj	P07	152,749€
10. Toka Bujqësore Bokshiq	P16	70,999€
11. Bujqësia – Tokë Bujqësore Potërq	P94	340,011€
12. Tokë bujqësore Ereniku – Baks II	P74	416,250€
13. Hotel Mineral	P40	173,330€
14. Karaqeva – Fabrika e vjetër e Pllakave	P35	605,689€
15. Agromorava Mulliri Elektrik	P45	301,000€
16. Agromorava Farma e Dhive	P46	41,111€
17. Morava e Epërme “Shtëpia e Mallrave e Vitisë”	P75	669,999€
18. Kosova Elektro Zyret Zona Industriale	P29	1,651,000€
19. Llapi Shitorja Nr. 26	P32	20,500€
20. NBI Suhareka Prona e Fermës së dhive	P11	667,000€
21. Fabrika e Lëkurës Bare		(pa oferta)